



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:040533

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734688

KE.nr.2649/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit The Coca – Cola Company, me seli në 310 North Avenue, N.W. Atlanta, Georgia 3031, SHBA, të cilin e përfaqëson Xhevdet Rama, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Vac Distribution” SH.P.K., me NUI: 811874420, me seli në rrugën “Zahir Pajaziti”, p.nr., në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Zyhdi Axhemi, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 25.04.2024, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datën 24.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit The Coca – Cola Company dhe VËRTETOHET se i padituri “Vac Distribution” SH.P.K., me datën 20.09.2022, përmes importimit të 64.350 litra (1.5L) të pijes së gazuar joalkoolike me shenjën “Coca-Cola”, ka shkelur markën tregtare të regjistruar të paditësit “Coca – Cola”.
- II. OBLIGOHET i padituri që me shpenzimet e tij të shkatërroj të gjitha mallrat si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- III. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit, në çfarëdo mënyre, përfshirë importimin, eksportimin dhe vendosjen në treg të produkteve që përbëjnë shkelje të markës tregtare të paditësit.

- IV. OBLIGOHET i padituri që me shpenzime të tij ta publikoj këtë aktgjykim në tri medime të Republikës së Kosovës, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- V. DETYROHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1611 €, (një mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi The Coca – Cola Company, me seli në SHBA, përmes të autorizuarit së tij, me datën 04.11.2022, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare, kundër të paditurit “Vac Distribution” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri duke tentuar importimin e 64.350 litrave të pijes së gazuar joalkoolike me shenjën Coca Cola, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit The Coca – Cola Company, sipas rastit doganor 373-2020, të datës 20.10.2022; të urdhërohet e paditura që ti shkatërroj me shpenzimet e veta të gjitha pijet e gazuara joalkoolike të importuara pa autorizim dhe apo pa pëlqimin e paditësit sipas rastit doganor 373-2022; të i ndalohet të paditurit çdo aktivitet i cili shkel markat tregtare të paditësit, në veçanti importimi, eksportimi dhe vendosja në treg të produkteve që përbëjnë shkelje të markës tregtare të paditësit; të detyrohet i padituri që ta publikoj në tërësi aktgjykimin në të paktën tri mjete të informimit publik kombëtar të Republikës së Kosovës me shpenzimet e veta; të urdhërohet Dogana e Kosovës që mallin e ndaluar sipas rastit 373-2022 ta mbajë deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi si dhe të detyrohet e paditura që ti kompensoj dëmin material dhe jo material të paditësit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe shpenzimet e procedurës së asgjësimit të mallrave kontestuese.

Në referatin e padisë ka theksuar që paditësi është njoftuar nga Dogana e Kosovës, se me datën 20.09.2022, është pezulluar lirimi i mallrave me shenjën “Coca – Cola”, me dyshimin se këto produkte shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale të paditësit, ndërsa i padituri nuk ka kundërshtuar ndalimin e mallit në sasi prej 64350 litra të pijes freskuese “Coca Cola”. Më tutje ka shtuar që nga foto dokumentacioni si dhe dalja në vendin e ngjarjes rezulton se i padituri pa autorizim ka distribuuar mallrat me shenjën e paditësit dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 të LMT-së.

I autorizuari i paditësit, gjatë seancave gjyqësore ka hequr dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit, ndërsa ka mbetur pranë padisë për kërkesat tjera, duke theksuar që i padituri ka shkelur markat tregtare të paditësit, pasi që me datën 20.09.2022, sipas numrit të rastit 373-2022 të pranuar nga Dogana e Kosovës, malli i ndaluar për verifikim, në sasinë prej 64,350 litra të pijes “Coca Cola”, sipas dokumentacionit ka rezultuar se është importuar nga shteti i Irakut. Ka shtuar se bartësi i së drejtës ka krijuar rrjetin e distributoreve të cilët janë të autorizuar që mallin ta distribuojnë në Republikën e Kosovës dhe se i padituri nuk është në këtë rrjet distribuimi, ndërsa paditësi ka marrëveshje me Shoqërinë Tregtare Kosovare “Coca Cola Hellenic Bottling Company – Kosovo” L.L.C., që të furnizoj, paketoj, distribuoj/shpërndaj dhe të shet të gjitha produktet sipas markës së regjistruar tregtare për territorin e Republikës së Kosovës.

Më tutje, paditësi ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi i të paditurit se në rastin konkret është bërë shterimi i të drejtave të fituara nga një markë tregtare, pasi që sipas nenit 14 të LMT-së, decidivisht përcaktohet se kur dhe në çfarë mase bëhet shterimi i të drejtave të fituara dhe se në rastin konkret malli është importuar nga Iraku, shtet i cili nuk është anëtar i BE-së, as nuk është shtet i Zonës Ekonomike Evropiane, si dhe nuk bën pjesë në rajonin e Ballkanit Perëndimor e po ashtu as Republika e Kosovës, nuk ka ndonjë marrëveshje të tregtisë së lirë me vendin nga vjen malli.

I ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi padinë si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri përmes të autorizuarit së tij, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Ka theksuar që mallrat kontestuese në rastin konkret janë importuar nga Republika e Turqisë përmes trajtës së importit me deklaratë eksportuese dhe ri-eksportuese për territorin e Kosovës dhe se i njëjti mall në Doganë është futur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të importit duke e përfshirë edhe certifikatën e origjinës së mallit.

Më tutje, ka shtuar se me datën 20.09.2022, Dogana e Kosovës e ka njoftuar bartësin e të drejtës – paditësin, lidhur me rastin Coca Cola 373-2022 mbi pezullimin e procedurës së zhdoganimit dhe të ndërmarrjes së masave doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, ndërsa paditësi ka tejkalluar apo nuk është përgjigjur fare në shkresat e Doganës, me

ç'rast edhe është informuar nga Dogana e Kosovës, se konform dispozitave ligjore malli do të lëshohet në qarkullim të lirë.

I padituri po ashtu ka theksuar që i njëjti ka vepruar në mirëbesim dhe se mallrat janë importuar nga Turqia, duke e poseduar të gjithë dokumentacionin relevant, ndërsa mallrat kontestuese janë ndaluar në sekestrim të përkohshëm në Doganën e Kosovës, me arsyetimin e mungesës së autorizimit nga ana e paditësit dhe me pretendimin se këto mallra janë importuar nga shteti i Irakut, edhe pse vendi i dërgesës së këtyre mallrave ka qenë Republika e Turqisë.

Në fund ka theksuar që paditësi me veprimet e tij, ka shkelur parimet e tregut të lirë dhe ka vepruar në favor të monopolit, duke i shkaktuar dëme të pariparueshme të paditurit, pasi që mallrat ende gjenden nën masat në depon kryesore të ZBD Merdare, të pa asgjësuar dhe me afat të skaduar. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 2973 numër aplikimi KS/R/2008/901, të datës 13.06.2008; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër të regjistrimit 5628, numër të aplikimit 987-2008, të datës 02.12.2013; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 5628, nr aplikimi KS/R/2008/987, i datës 17.06.2008; Deklarata zyrtare, lëshuar nga The Coca Cola Company, e datës 04.10.2022, për rastin 373-2022 në gjuhën angleze dhe e përkthyer në gjuhën shqipe; Listë distribuimi – njoftim nga Dogana e Kosovës, rasti 373-2022 Coca Cola, i datës 20.09.2022; Fotografia e tiketës / ambalazhit të produktit të ndaluar nga Dogana e Kosovës si dhe Procesverbali me numër serik 0010529, i datës 30.01.2023 së bashku me fotografinë e produktit kontestues.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas Vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 2973 numër aplikimi KS/R/2008/901, të datës 13.06.2008, vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës

tregtare me numër të regjistrimit 5628, numër të aplikimit 987-2008, të datës 02.12.2013 dhe vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 5628, nr. aplikimi KS/R/2008/987 të datës 17.06.2008, vërtetohet se paditësi e ka regjistruar dhe e ka vazhduar regjistrimin pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare “Coca - Cola”, si dhe i njëjti është bartës i të drejtës së këtyre markave tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 32 të Klasifikimit të Nicës.

Sipas Listës së distribuimit – Njoftim nga Dogana e Kosovës rasti 373-2022 Coca Cola, të datës 20.09.2022, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të së drejtës së markave tregtare të paditësit. Nga fotot e prezantuara të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit përmbajnë shenja identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit.

Nga deklarata zyrtare e lëshuar nga The Coca Cola Company të datës 04.10.2022, është konstatuar se produktet e ndaluara nga Dogana e Kosovës me datën 20.09.2022, sipas rastit 373-2022, janë produkte të cilat shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale të “The Coca Cola Company” dhe të njëjtat janë importuar pa autorizimin e tyre.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markat tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta që të: ndalojë

përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion, të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës, si dhe të disponojë me markën tregtare të tij.

Mbajtësi i një marke tregtare sipas nenit 9 të LMT-së, ka të drejtë që të ndalojë vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e tij për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas nenit 9 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njërën prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes importimit të mallrave: 64350 litra (shishe 1,5 litra) pije e gazuar joalkoolike me shenjën Coca Cola, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit The Coca – Cola Company, me numër të regjistrimit 5628 dhe 2973.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurit se mallrat kontestuse janë importuar nga Republika e Turqisë dhe se bartësi i markës tregtare nuk mund ta ndalojë përdorimin e produkteve, pasi është bërë shterimi i të drejtës pas shitjes së parë, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë, në rastin konkret është i pa bazuar për arsyet si në vijim:

Sipas dispozitës së nenit 14 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare, përcaktohet se:
“1. Pronari nuk mund të ndalojë përdorimin e markës tregtare në produktin që pronari ka vendosur në treg në njërin nga këto vende: 1.1. Republika e Kosovës; 1.2. shteti anëtar i Bashkimit Evropian; 1.3. shteti anëtar i Zonës Ekonomike Evropiane; 1.4. shteti i rajonit të Ballkanit Perëndimor; 1.5. shteti me të cilin Republika e Kosovës ka marrëveshje të tregtisë së lirë ose lehtësira tregtare”.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur, rezulton se pronari i markës tregtare nuk mund të ndaloj përdorimin e markës në produktet që vendosen në njëerën nga shtetet e përcaktuara sipas nenit 14 të LMT-së, me kushtin që të njëjtave produkte nuk i është ndryshuar apo dëmtuar cilësia pas vendosjes së tyre në treg, si dhe në rastet kur origjinaliteti i produktit nuk kontestohet nga pronari i markës.

Mirëpo duke marr për bazë faktin, që në rastin konkret produkti i ndaluar në Doganën e Kosovës, është kontestuar nga paditësi, ndërsa nga deklarata mbi origjinalitetin është konstatuar që produkti i ndaluar në Doganën e Kosovës, shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit, rezulton se pretendimi i të paditurit për ezaurimin (humbjen) e të drejtave të markës tregtare (exhaustion of rights principle) – apo parimit të “shterjes së të drejtave” pas “shitjes së parë”, është i pabazuar dhe si i tillë nuk gjen zbatim në rastin konkret.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe provat e tjera të bashkëngjitura, mirëpo gjeti se nga të njëjtat nuk mund të vërtetohet ndonjë lidhshmëri me produktin i cili është ndaluar nga Dogana e Kosovës nën dyshimin për shkeljen e markave tregtare të paditësit.

Gjykata e ka refuzuar paraqitjen e kundërpadisë të datës 25.04.2024, nga e paditura Vac Distribution SH.P.K., ndaj paditësit The Coca Cola Company, për arsyet si në vijim:

Sipas dispozitës së nenit 256 par. 1 të LPK-së, përcaktohet se: *“I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi derisa nuk ka përfunduar seanca përgatitore, gjegjësisht seanca e parë për shqyrtimin kryesor, po që se seanca përgatitore nuk është mbajtur fare në qoftë se: a) kërkesa e kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë (kundërpadia kodekse); b) midis kërkesëpadisë dhe asaj të kundërpadisë mund të bëhet kompensimi (kundërpadia kompensuse); c) me kundërpadi kërkohet vërtetimi i ndonjë të drejte apo raporti juridik nga ekzistimi apo mosekzistimi i të cilit varet tërësisht apo pjesërisht vendimi mbi kërkesën e paditësit (kundërpadia prejudiciale)”*. Ndërsa sipas par.2 të këtij neni përcaktohet se: *“Pas mbajtjes së seancës nga paragrafi 1 i këtij neni, kundërpadia mund të ngrihet vetëm me pëlqimin e paditësit.”*

Në rastin konkret, duke u bazuar në dispozitën e sipërcituar dhe meqenëse paditësi nuk ka dhënë pëlqimin që të lejohet paraqitja e kundërpadisë, gjykata ka refuzuar propozimin e të paditurit dhe nuk ka lejuar paraqitjen e kundërpadisë pasi që e njëjta është paraqitur në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.04.2024. Po ashtu edhe nga përmbajtja, rezulton se parashtrësia

nuk i ka përmbajtur elementet e kërkuara sipas dispozitës së nenit 253 të LPK-së, pasi që përveç pretendimeve deklarative, nuk ka përmbajtur fare kërkesë.

Gjykata po ashtu ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditurit për shtyerjen e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 25.04.2024, me qëllim të sigurimit të provave për vendin e dërgesës / shtetin e dërgesës së mallrave kontestuese, meqenëse ka vlerësuar se i padituri ka pasur kohë të mjaftueshme për sigurimin e provave, si dhe duke marr për bazë faktin që Gjykata veçse kishte shtyer seancën e datës 18.04.2024, me propozimin e të paditurit. Për më tepër, në arsyetimin e kërkesës për shtyerjen e seancës së datës 25.04.2024, i autorizuari i të paditurit ka deklaruar që shkak për mos sigurimin e provave të lartcekura, ka të bëjë me faktin që vet pala e paditur deri në këtë stad të procedurës nuk ia ka siguruar provat.

Sipas nenit 7 të LPK-së, i cili përcakton detyrimin e palëve për vërtetimin e fakteve mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe nenit 319 të LPK-së, i cili përcakton se secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta, rezulton se e paditura ka pasur për detyrim që të ofroj prova me të cilat do të argumentonte pretendimit e tij. Prandaj, gjykata ka vlerësuar se kërkesa e të autorizuarit të paditurit, nuk gjen mbështetje ligjore, meqenëse e njëjta ka pasur qëllim vetëm që të zvarritet më shumë procedura gjyqësore.

Vendimin për shkatërrimin e produkteve me shpenzimet e të paditurit dhe vendimin për publikimin e këtij aktgjykimi në mjetet e informimit, gjykata e morri konform dispozitave të nenit 83 dhe 92 par. 5 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare i Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi me zbatimin e rritjes prej 100% për shkak të kontestit me element të huaj sipas tarifës së OAK dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 208 €, për taksën gjyqësore shumë prej 51.00 € si dhe përfaqësim në pesë seanca gjyqësore shumë prej 1352 €, (270.40 € x 5), në shumë të përgjithshme prej 1611 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2649/22, datë 24.05.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.